Aktualitet

# Tentoi të vriste me armë zjarri të dënuarin më parë, arrestohet 30-vjeçari në Maliq

*Arrestohet për tentativë vrasje 30 vjeçari Juxhin Qesaraka në Maliq*



*Të sekuestruara nga policia*

[Sh].com Redaksia
23 Qershor, 10:06 | Përditesimi i fundit: 23 Qershor, 10:13

Arrestohet për tentativë vrasje 30 vjeçari Juxhin Qesaraka në Maliq.

Gjatë një konflikti për motive të dobëta Qesaraka, qëlloi me armë zjarri 29-vjeçarin e dënuar më parë për armëmbajtje pa leje. 29 vjeçari nuk ka marrë lëndime nga të shtënat ndërsa përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit është parandaluar nga policia.



LEXO EDHE:
**Bie nga skela e katit të 2-të duke punuar, 59-vjeçari nga Pogradeci dërgohet me helikopter drejt Tiranës**

Sekuestrohen krëhëra automatiku dhe pushke, si dhe municion luftarak.

**Njoftimi i policisë:**

Tentoi të vriste me armë zjarri një shtetas, gjatë një konflikti për motive të dobëta, bie në prangat e Policisë 30-vjeçari. Sekuestrohen krëhëra automatiku dhe pushke, si dhe municion luftarak.

Mbrëmjen e djeshme rreth orës 22:30, pas marrjes së njoftimit se në fshatin Pendavinj, Maliq, shtetasi J. Q., 30 vjeç, gjatë një konflikti për motive të dobëta, me shtetasin B. D., 29 vjeç (i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje), të dy banues në fshatin Pendavinj, kishte qëlluar me armë zjarri tip automatik në drejtim të tij, pa i shkaktuar lëndime, shërbimet e Komisariatit të Policisë Maliq, në bashkëpunim me Strukturat për Hetimin e Krimeve në Dvp Korçë dhe Forcat Speciale "Shqiponjat", shkuan menjëherë në vendngjarje dhe falë ndërhyrjes së shpejtë, bënë të mundur parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit, kapjen dhe ndalimin e autorit të dyshuar të ngjarjes.

Nga veprimet e mëtejshme dhe kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit J. Q., u gjetën e sekuestruan në cilësinë e provës materiale krëhëra automatiku dhe pushke, pjesë të tjera përbërëse të armëve të zjarrit dhe municion luftarak.

Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprat penale "Vrasja me dashje", e mbetur në tentativë dhe "Armëmbajtja pa leje".

Be.K./Shqiptarja.com

TAG: korce | te shtena me arme | maliq | Juxhin Qesaraka

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A mendoni se ulja e numrit të aksidenteve rrugore bëhet vetëm duke gjobitur shoferët?**

PO | JO | NUK E DI

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

Në 18:00 për 1/8 e Euro 2020 Çekia sfidon Holandën! 'Tulipanët' favoritë duan çerekfinalen me Danimarkën
27 Qershor, 11:46

Aktualitet

Masakra në Velipojë, në vendin e ngjarjes gjenden 4 lloj armësh
27 Qershor, 11:45

Aktualitet

Dita e parë e punës iu bë e fundit e jetës, viktima më e pafajshme e masakrës në Velipojë! 20 vjeçarit jetim në xhep iu gjetën vetëm 30 lekë
Anila Prifti
27 Qershor, 11:31

Aktualitet

Sherr mes taksistëve në Sarandë, 32-vjeçari plagos rëndë me sëpatë të riun! Arrestohet autori
27 Qershor, 11:24

Aktualitet

Me shpejtësi sketërre shkaktoi aksidentin ku humbën jetën 4 anëtarët e familjes Gushi! Lihet në burg 22-vjeçari Igli Madani
27 Qershor, 11:20

Aktualitet

Manastirliu: Nëse jeni mbi 18-vjeç, nga sot mund të aplikoni në portalin e-Albania për t'u vaksinuar kundër COVID
27 Qershor, 11:19

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton






© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje